



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr.96/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arben Toska, në çështjen përmbarimore për kërkesë në të holla të kreditorit të përmbarimit “Kompania Rajonale e Mbeturinave Ambienti” ShA me seli në rrugën Fatmir Ukaj nr. 24 në Pejë kundër debitorit të përmbarimit “NPQ Posta e Kosovës” ShA me seli fshatin Gurrakoc të Istogut, objekti i përmbarimit kërkesa në të holla, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të përmbarimit të ushtruar kundër urdhrit përmbarimor P.nr.291/2021 të datës 30.12.2021 të përmbaruesit privat Atip Mustafa me seli në Mitrovicë, jashtë seancës me datë 29 shtator 2023, mori këtë:

AKTVENDIM

- I. Pranohet si bazuar prapësimi i debitorit të “NPQ Posta e Kosovës” ShA me seli në Istog, anulohet urdhri përmbarimor P.nr.291/2021 i datës 30.12.2021 i përmbaruesit privat Shpend Ahmetaj me seli në Pejë dhe përfundohet në tërësi procedura përmbarimore në këtë çështje.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta lidhur me këtë procedurë në gjykatë, sipas prapësimit të debitorit të përmbarimit.

ARSYETIM

Kreditori “Kompania Rajonale e Mbeturinave Ambienti” ShA me seli në Mitrovicë (këtu e tutje Kreditori) më 30.12.2021 ka parashtruar propozim për përmbarim (këtu e tutje Propozimi) në zyrën e përmbaruesit privat Shpend Ahmetaj me seli në Pejë (këtu e tutje Përmbaruesi), me të cilin ka kërkuar që të detyrohet debitori i përmbarimit “NPQ Posta e Kosovës” ShA me seli në Istog (këtu e tutje Debitori) që t’ia paguaj shumën prej 941.04€ me kamatëvonesë vjetore prej 8% dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore. Propozimin për përmbarim e kishte bazuar në kartelën e konsumatorit për periudhën kohore 30.06.2006 deri 30.11.2019 dhe kartelën e konsumatorit për periudhën kohore 31.12.2019 deri 30.11.2021 si dhe faturën 135135 të datës 30.11.2021, të gjitha në emër të Debitorit, të cilat në origjinal ia ka bashkëngjitë Propozimit.

Përmbareuesi më 30.12.2021 e ka nxjerrë urdhrin përmbareimor P.nr.291/2021, me të cilin e ka lejuar në tërësi përmbareimin sipas Propozimit (këtu e tutje Urdhri).

Debitori më 03.03.2022 ka parashtruar prapësim (këtu e tutje Prapësimi) duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbareimor dhe i ka kërkuar gjykatës që ta anuloj atë. Ai ka deklaruar se Propozimi dhe Urdhri janë në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, pasi Propozimi nuk është i nënshkruar nga Kreditori. Ka shtuar se faturat lëndore dhe kartelat nuk i ka pranuar asnjëherë, rrjedhimisht nuk janë dokumente të besueshme. Gjithashtu ka deklaruar se këto fatura dhe kartelat nuk janë dorëzuar në origjinal ose në kopje të vërtetuara së bashku me Propozimin. Përveç kësaj, ai e ka kundërshtuar Propozimin dhe kartelat lëndore me pretendimin se ato nuk i përmbajnë të dhënat për Debitori, gjegjësisht nuk e përmban numrin e biznesit të tij. Sipas tij, mungon fatura e rregullt e Kreditorit e cila duhet domosdoshmërisht të jetë në origjina, të dorëzohet dhe pranohet nga debitori si element bazë për pagesën e borxhit si dhe koha e përmbushjes së detyrimit, në mënyrë që të plotësohet kushti i një dokumenti të besueshëm për ekzekutim. Më tutje ka kundërshtuar se kërkesa e Kreditorit është parashkruar sipas nenit 341 lidhur me nenin 355 të LMD-së. Debitori e ka shtuar se Kreditori borxhin eventual duhet ta kërkojë nga Telekom i Kosovës ShA, pasi sipas kontratës së datës 27.07.2012 që ka me Telekomin e Kosovës, kjo e fundit e ka për obligim që t'i paguaj të gjitha shërbimet komunale, përfshirë edhe këto të mbeturinave. Prapësimi i ka bashkëngjitur kontratën 1822 të datës 27.07.2012 ndërmjet Debitorit dhe “Posta dhe Telekom i Kosovës” ShA, si dhe e ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve procedurale lidhur me paraqitjen e Prapësimi.

Kreditori në përgjigjen e tij në Prapësim ka kërkuar që të refuzohet në tërësi si i pabazuar Prapësimi i Debitorit. Ai ka deklaruar se Prapësimi nuk e përmban asnjë nga shkaqet e nenit 71 të LPP-së dhe nuk përmban asnjë provë relevante. Ka shtuar se kundërshtimi Debitorit për parashkrimin e kërkesës është i pabazuar sepse ai ka bërë disa pagesa të borxhit. Përgjigjes në prapësim nuk ia ka bashkëngjitur asnjë provë, si dhe nuk e ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve procedurale lidhur me paraqitjen e përgjigjes në prapësim.

Pas shqyrtimit të pretendimeve të Debitorëve të paraqitura në Prapësim dhe deklarimeve të Kreditorit në përgjigje ndaj prapësimi, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, gjykata gjeti se prapësimi është i bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Kreditori në emër të Debitorit i ka nxjerrë kartelën e konsumatorit për periudhën kohore 30.06.2006 deri 30.11.2019 dhe kartelën e konsumatorit për periudhën kohore 31.12.2019 deri 30.11.2021 që për nga përmbajtja paraqesin ekstrakt të

verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave (këtu e tutje Ekstrakti), si dhe faturën 135135 të datës 30.11.2021 e cila është pjesë e ekstraktit të fundit, të cilat në origjinal ia ka bashkëngjitur Propozimit. Ekstraktet përmbajnë të dhëna për kreditorin dhe debitorin, si dhe objektin, llojin dhe shumën, por atyre i mungon koha e përmbushjes së detyrimit monetar. Fatura gjithashtu i përmban të dhëna për kreditorin dhe debitorin, si dhe objektin, llojin dhe shumën, si dhe kohën e përmbushjes së detyrimit monetar. Megjithatë në të nuk është as vula e as nënshkrimi i Debitorit. Në shkresat e lëndës nuk ka prova se Kreditori ka paraqitur deklaratë me shkrim se kredia e tij është bërë e kërkueshme duke u treguar edhe ditën për një gjë të tillë. Gjithashtu, nga shkresat e lëndës nuk rezulton se Përmbaruesi i ka kërkuar Kreditorit që ta bëjë një gjë të tillë para se të caktoj përmbarimin.

Kjo situatë rregullohet në rend të parë me nenin 29 të LPP-së, i cili në para. 1 nënpara. 2 dhe 3 ka rregulluar se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është (...) 1.2 ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave; 1.3. faturat;”* ndërsa në para. 3 ka paraparë se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Në anën tjetër, neni 30 i LPP-së ka paraparë se *“Kur nga dokumenti i besueshëm nuk shihet se a është bërë e kërkueshme kredia, atëherë përmbarimi caktohet vetëm në qoftë se kreditori paraqet deklaratë me shkrim se kredia e tij është bërë e kërkueshme duke u treguar edhe dita për një gjë të tillë”*.

Nga këto dispozita rrjedhë se, përmbarimi mund të caktohet edhe në bazë të ekstraktit të verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave si dokument i besueshëm dhe se për ta caktuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm, ai duhet ta ketë përmbajtjen e kërkuar ligjore, gjegjësisht mes tjerash ta përmbaj kohën e përmbushjes së detyrimit, qoftë në formë të datës fikse qoftë në formë të afatit, e në mungesë të kohës së përmbushjes, atëherë Kreditori e ka mundësinë ligjore që të paraqes deklaratë me shkrim para organit të përmbarimit në të cilin tregon kohën se kur është bërë e arritshme kërkesa e tij. Në këtë drejtim, LPP as në nenin 29 e as në ndonjë dispozitë tjetër juridike të tij nuk e ka përjashtuar këtë kërkesë ligjore për ekstraktet e verifikuara. Në rastin konkret, ekstrakteve lëndor u mungojnë të dy format e përcaktimit të kohës për përmbushjen e kërkesë që rrjedhë nga dokumenti i besueshëm.

Si rezultat i mungesë së kohës së përmbushjes së detyrimit monetar në Ekstrakte vjen deri te mungesa e tipareve të përmbarueshmërisë së dokumentit të besueshëm. Për pasoj duhet të zbatohet neni 71 para. 1 nënpara. 1.1 të LPP-së, sipas të cilit “(..) *prapësimi mund të bazohen vetëm nëse dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbarueshmërisë*”.

Sa i përket faturës lëndore, gjykata rikujton se ajo nuk e përmban nënshkrimin as nënshkrimin e as vulën e Debitorit, që nënkupton se ajo nuk është pranuar nga ai. Gjykata gjithashtu konstaton se nuk ka asnjë provë nga e cila do të provohej se Debitori në ndonjë mënyrë e ka pranuar faturën lëndore. Si rezultat i mungesë së pranimit kësaj fature, vjen deri te mungesa e tipareve të përmbarueshmërisë së dokumenteve të besueshëm. Edhe në këtë rast duhet të zbatohet neni 71 para. 1 nënpara. 1.1 të LPP-së, sipas të cilit “(..) *prapësimi mund të bazohen vetëm nëse dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbarueshmërisë*”.

Për gjykatën, mungesat e elementeve thelbësore në dokumentin e besueshëm, të cilat u sqaruan më lartë, paraqet pengesë të pakapërcyeshme ligjore, për shkak të cilës nuk mund të lejohet përmbarimi, rrjedhimisht e anuloi Urdhrin. Meqenëse në këtë procedurë përmbarimore nuk kishte çështje tjetër për tu trajtuar, atëherë gjykata vendosi ta përfundon procedurën në tërësi, siç përcakton neni 73 para. 4 i LPP-së.

Edhe pretendimet tjera të Kreditorit dhe Debitorit u morën parasysht, mirëpo nuk ishin relevante për vendosje ndryshe nga dispozitivi i këtij aktvendimi.

Gjykata e sheh të rëndësishme të sqaroj se, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës vlerësoi se nuk është e domosdoshme të caktohet seancën gjyqësore për ta kuptuar plotësisht validitein e Prapësimit, siç ka caktuar neni 73 para. 1 i LPP-së, meqë nga shkresat e lëndës gjendja faktike dhe juridike ishte qartë.

Gjykata vendosi që secila palë t'i bartë shpenzimet e saj lidhur me këtë procedurë në gjykatë sipas prapësimit të Debitorit, pasi për gjykatën kërkesa e Debitorit si palë gjyqëfituese për shpërblimin e shpenzimeve procedurale është e pabazuar, meqenëse ajo nuk ishte e specifikuar siç kërkon neni 463 para. 2 të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së, gjegjësisht nuk cekur shuma e saktë e shpenzimit. Në përgjigjen në prapësim shprehimisht thuhet që të “*Obligohet Kreditori që t'i bartë shpenzimet e procedurës, në lartësinë të cilën e përcakton kjo gjykatë*”. Gjykata gjithashtu vërejt se Prapësimi nuk ishte përpiluar nga avokati ose subjekt tjetër të cilit në bazë të ligjit i takon

shpërblimi për punën e tij, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka prova që provojnë se Debitori ka pasur shpenzime për përpilimin e Prapësimit, siç kërkon neni 463 para. 2 i LPK-së.

Më kuptim të nenit 73 para. 3 të LPP-së lidhur me nenin 13 para.1 nën para. 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi

Gjykata Komerciale e Kosovës  
Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike  
KPPP.nr.96/2023

Gjyqtari

---

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese ndaj këtij aktvendimi brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.